



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 25.10.2024)*

*Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:08 dhe mbaroi në orën 13:18.*

Në mbledhje ishin të pranishëm online:

- |                               |                           |
|-------------------------------|---------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i>           | <i>(kryetar)</i>          |
| <i>2. Yllka Rupa</i>          | <i>(zëvendëskryetare)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i>     | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>4. Irena Plaku</i>         | <i>(anëtare)</i>          |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i>      | <i>(anëtare)</i>          |
| <i>6. Ridvan Hado</i>         | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>7. Bledar Bajri</i>        | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>8. Albens Tabaku</i>       | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>9. Markelian Koça</i>      | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>10. Violanda Theodhori</i> | <i>(anëtar)</i>           |
| <i>11. Emona Muçi</i>         | <i>(anëtare)</i>          |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Maela Alicanaj, Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 25.10.2024*

### *3. Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje edhe një herë të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë, për shkak të një kërkesë urgjente nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe me materialet e përgatitura nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 25.10.2024, ora 13:00, për shkak edhe të krijimit të kuorumit të nevojshëm.

Meqenëse është mbledhja jonë e parë pas zgjedhjes time si Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju uroj suksese në punën tonë të përbashkët, në realizimin e misionit të cilin kemi si objektiv kryesor.

Rendi i ditës ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit z. Kryetar!

Unë po e filloj aty ku e latë ju, meqenëse është mbledhja e parë pas përzgjedhjes së përfaqësuesve, drejtues në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit. I uroj suksese nga ana ime edhe Kryetarit edhe Zëvendëskryetares në detyrë. Suksese dhe me krahë të lehta.

Menjëherë pas këtij urimi unë po prezantoj një material që është paraqitur përpara të gjithë kolegëve, që ka për objekt caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizua. Në fakt është një relacion i cili ka lidhje me relacionin e fundit që ne kemi prezantuar në mbledhjen e Këshillit, që bënte fjalë për caktimin e trupave gjykues në gjykimin e dy çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në njërin prej këtyre çështjeve, si një prej anëtarëve të trupit gjykues u përzgjedh me short gjyqtari {...}. Menjëherë pas përzgjedhjes, në fillimin e

veprimtarisë së tij për të vënë në lëvizje dosjen që iu ngarkua për gjykim, z. {...} ka paraqitur kërkesën për dorëheqje përpara Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe kërkesa i është pranuar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për shkaqe papajtueshmërie, pasi zoti {...} në kohën që ai ka ushtruar funksionet dhe i ushtron aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka gjykuar në fazën e hetimeve paraprake, ka kryer veprime për të njëjtën çështje e cila më pas për shkak të kompetencës lëndore është hetuar nga Prokuroria e Posaçme. Kështu që ndodhur në këto kushte, meqenëse zoti {...} ka pasur papajtueshmëri në lidhje me gjykimin e kësaj çështjeje pasi ka kryer veprime si gjyqtar i hetimeve paraprake në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës; dhe pranimi të kërkesës për heqje dorë, ne, me kërkesë rishtazi të sjellë nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Posaçme, vihem në lëvizje për të bërë plotësimin e trupit gjykues me një gjyqtar tjetër të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për të zëvendësuar zotin {...}.

Kërkesa e paraqitur është e datës 25.10.2024 dhe arsyet e kërkesës unë i përmenda më lart, që kanë të bëjnë me zëvendësimin e zotit {...}.

Në këtë rast zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarëve dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhet i pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret.

Ndodhur në këto kushte ne si Komision propozojmë që të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme. Këto propozime mbështeten në paragrafin e 10-të, pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme. Njëkohësisht këto propozime mbështeten edhe në referencat ligjore të parashikuara në të njëjtin vendim, por në pikat 5, shkronja C, Kreu i IV i vendimit, si dhe në paragrafin e 6-të, pika 4 të tij.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bëri këtë relativitet i propozon mbledhjes:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Pra nga të gjithë gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të

paktën pesë vjet si gjyqtarë për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Në opsionin e pranimit të propozimit të mësipërm, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 (një) i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Përjashtimet nga shorti:

Referuar paragrafit të 8-të të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit të mësipërm.

Në përmbajtjen e relacionit unë e përmenda më lart, janë të përcaktuar të gjithë gjyqtarët që kanë pengesa ligjore për t’u përfshirë në këtë short. Në relacionin e fundit unë i kam përmendur një nga një gjyqtarët. Mendoj që nuk është e dobishme që të ripërsëris edhe një herë emrat e të gjithë gjyqtarëve që unë i thashë, i përmenda pra në relacionin e fundit që ka të bëjë me të njëjtën çështje për të cilën kërkohet edhe plotësimi i trupit gjykues.

Pra nga ky rregull i përgjithshëm duhet të bëjmë përjashtime dhe ne bëjmë propozimet tona: Gjyqtarët të cilët kanë qenë më përpara ish-anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar pengesave ligjore dhe qëndrimit të mbajtur më parë nga Këshilli, siç janë gjyqtarët: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}. Janë gjyqtarë të cilët ne kemi mbajtur qëndrim, kanë qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kemi mbajtur qëndrimin që ish-anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë pengesë ligjore në vlerësimin tonë, të përfshihen në procesin e përzgjedhjes nëpërmjet shortit për të plotësuar trupat gjykues në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë.

Njëkohësisht propozojmë që edhe znj. {...}, në kushtet kur njëri nga anëtarët e trupit gjykues të kësaj çështjeje për të cilën kërkohet caktimi i një gjyqtari të ri është gjyqtari z. {...}, bashkëjetues i znj. {...}, ne propozojmë që edhe zonja {...} të mos jetë pjesë e shortit që do të hidhet midis gjyqtarëve të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.

Lista e gjyqtarëve është listë e bashkëlidhur relacionit. Për të gjithë anëtarët ne kemi përgatitur listën përkatëse dhe janë gjithsej 37 gjyqtarë që janë përfshirë në këtë listë për t'iu nënshtruar shortit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u prezantua nga relatori në lidhje me mekanizmat që do të përdoren për realizimin e këtij shorti dhe për listën e magjistratëve të përfshirë në këtë short?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Atëherë, ftoj administratën të vazhdojë me hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatori.

*Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 107, gjyqtar i përzgjedhur Aurel Arapi.

***Ilir Rusi:*** Ju faleminderit!

Ju uroj një fundjavë të qetë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**